



Npi – 01/272 Datë: 24.11.2020

Duke u bazuar në nenin 12.2 pika (d) neni 17 pika (a) dhe (c), dhe nenin 58 pika (h) të Ligjit mbi Vetqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr 28/2008); Nenit 24 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, Nr.06-L-092; Nenin 29 paragrafi 5 i Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës. Kuvendi Komunës së Shtimes, në mbledhjen e mbajtur më 24.11.2020 mori këtë:

V E N D I M

**PËR SHPALLJEN ME INTERES PUBLIK TË NGASTRAVE KADASTRALE
Nr. 313/3, 313/4, 313/5, 313/6, Z.K – DAVIDOVÇ, PRONË E SALI BEQAJ – PETROVË**

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -IX- të rregullt për vitin 2020, e mbajtur më 24.11.2020, me shumicën e votave APROVOI Vendimin për shpalljen me Interes Publik të Ngastrave Kadastrale me numër Nr.313/3, 313/4, 313/5 dhe 313/6, Zona Kadastrale – Davidovc, Kultura: Kullosë e klasës së -I-. Evidentuar pronë e Sali Beqaj – Petrovë, me gjithsej sipërfaqe: 10.248m², (Dhjetë mijë e dyqind e katërdhjet e tetë).

II

A r s y e t i m: Qëllimi i shpalljen me Interes Publik të Ngastrave Kadastrale me numër Nr.313/3, 313/4, 313/5 dhe 313/6, Zona Kadastrale – Davidovc, Evidentuar pronë e Sali Beqaj – Petrovë, bëhet me qëllim të rregullimit të varrezave të fshatit, Parkut rekreativ sportiv, si dhe objekte të tjera me interes publik, të cilat do ti parsheh, Plani Zhvillimor i Komunës 2009-2020.

III

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palëve, Drejtorisë, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për informim.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj